



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 1615 prot.

Tiranë më, 15.11.2021

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 08, datë 15.11.2021

PËR

**HETIMIN DHE NDJEKJEN PENALE EFEKTIVE TË VEPRAVE PENALE ME TË
MITUR NË KONFLIKT ME LIGJIN, VIKTIMË DHE/OSE DËSHMITAR**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronjat “b” e “dh” dhe 46 pika 3 shkronja “c” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kodit Penal, Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Kodit të Procedurës Penale dhe Konventës së OKB mbi të Drejtat e Fëmijës¹ (Nju Jork 1989) dhe Protokollit të saj shtesë e ratifikuar me 27.02.1992.

UDHËZOJ:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1
Qëllimi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim rritjen e eficencës, efektivitetit dhe reduktimin e afateve, dhe jo vetëm, në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve me/dhe ndaj të miturve, në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar, të udhëhequr nga parimet e një drejtësie penale sa më miqësore dhe i interesit më të lartë të të miturit si dhe garantimi i drejtave të tyre, në mënyrë që të kontribuohet në uljen e kriminalitetit te të miturit, në

¹ Shih, Konventa e OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (1989)¹ e ratifikuar/aderuar/hyrë në fuqi për Shqipërinë me 27.02.1992.

rehabilitimin, riintegrimin dhe eliminimin e dhunës ndaj tyre.

2. Udhëzimi synon dhe unifikimin e disa procedurave e akteve procedurale penale në çështjet me të mitur, në përputhje me praktikat më të mira dhe standarde ndërkontinentare në drejtësinë penale për të mitur.

Neni 2 **Objekti**

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

a) Përcaktimi i të drejtave dhe garancive te të miturit në konflikt me ligjin, si dhe i masave procedurale e administrative për të siguruar zbatimin e tyre.

b) Përcaktimi i të drejtave dhe garancive mbi të miturit viktimitë dhe/ose dëshmitar, si dhe i masave procedurale e administrative për ti mbrojtur, asistuar dhe siguruar zbatimin e të drejtave të tyre.

c) Përcaktimi i aspekteve të politikës penale ndaj të miturve në konflikt me ligjin.

ç) Përcaktimi i masave të përgjithshme administrative lidhur me kontrollin/mbikëqyrjen e veprimtarisë së policisë gjyqësore, bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional, si dhe trajnimin e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe koordinatorëve të përfshirë.

2. Në anekset 1 deri 9 bashkëlidhur këtij udhëzimi, trajtohen modele formularë tip për unifikimin e procedurave dhe akteve procedurale penale në çështjet me të mitur në prokuroritë e juridikacionit të përgjithshëm.

Neni 3 **Garancitë**

1. Në procesin penal, dhe jo vetëm, çdo vendim apo veprimtari që lidhet me viktimen e mitur duhet të mbajë parasysh interesin më të lartë të saj². Prokurori, policia gjyqësore pranë çdo shërbimi policor, strukture/seksioni hetimor apo agjencie ligjzbatushë dhe koordinatorët për të miturit në prokuroritë e juridikacionit të përgjithshëm duhet të argumentojnë ose të jenë në gjendje të argumentojnë në çdo rast se si është siguruar respektimi i interesit më të lartë të të miturit në konflikt me ligjin, viktimitë dhe/ose dëshmitar në procesin penal.

2. I mituri në konflikt me ligjin ose viktimet përfiton pa pagesë shërbimet e detyrueshme sipas legjislacionit procedural dhe atij për drejtësinë penale për të mitur³, përfshirë ndihmën ligjore dhe atë psikologjike⁴.

3. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të caktuar për çështjet penale me të pandehur, viktima apo dëshmitar të mitur duhet të jenë të trajnuar në këtë fushë⁵.

4. E drejta e të miturit për jetë private respektohet në çdo fazë të procesit penal, që nga marrja dijeni për veprën penale, duke garantuar mosdëmtimin e tij nga nxjerra apo

² Shih, nen 10 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (në vijim KDPM-së).

³ Shih, nen 23 i KDPM-së.

⁴ Shih, nen 20 i KDPM-së.

⁵ Shih, nen 25 e vijues të KDPM-së.

publikimi i informacionit⁶. Respektimi i këtyre të drejtave të miturve, përbën detyrim ligjor për prokurorin dhe oficerin e policisë gjyqësore pér të marrë masat e duhura procedurale që çdo pjesëmarrës në administrimin e drejtësisë pér të mitur, të jetë i detyruar të ruajë konfidencialitetin me pasojë deri përgjegjësinë penale.

KREU II MBI TË MITURIN NË KONFLIKT MË LIGJIN

Neni 4

E drejta pér t'u informuar⁷

Prokurori dhe oficeri i Policisë Gjyqësore duhet të marrin masa e duhura, pér të respektuar me rigorozitet dispozitat procedurale penale, pér të informuar të miturin menjëherë në formën që i përgjigjet zhvillimit të tij, drejtpërdrejtë dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor mbi akuzën/at e ngritura kundër tij dhe të drejtat në procesin penal, si të drejtën pér përkthim/interpretim, të drejtën pér të përsituar ndihmë juridike falas, të drejtën pér ndihmë konsullore pér të mitur të huaj, të drejtën pér ankim, si dhe çdo ndihmë tjetër të nevojshme pér mbrojtjen e tij dhe të parashikuar në ligj.

Neni 5

E drejta pér mbrojtje efektive⁸

1. Prokurori duhet të marrë të gjitha masat pér t'i garantuar të miturit dhe mbrojtësit të tij përgatitjen dhe paraqitjen e një mbrojtje efektive, duke përfshirë, por pa u kufizuar, të drejtën që në kushte të barabarta, të pyesë dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, moskryerjen e veprimeve procedurale pa praninë e detyrueshme të mbrojtësit si dhe të drejtën pér akses në provat e mbledhura gjatë hetimeve paraprake.

2. Pér të siguruar të drejtën e pjesëmarrjes dhe mbrojtjes së drejtpërdrejtë të të miturit në konflikt me ligjin, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore e informon menjëherë dhe gjatë gjithë procesit, pér të drejtat dhe garancitë procedurale. Të miturit, i vihet në dispozicion “Letra e të drejtave të miturit në konflikt me ligjin”, sipas modelit Aneksi 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 6

Shmangia nga ndjekja penale dhe nga dënim i përmes masave alternative

1. Prokurori në çdo rast vlerëson marrjen e masës së shmangies ndaj të miturit në konflikt me ligjin.

⁶ Shih, nenet 21 dhe 33 të KDPM-së dhe nenin 58/a pika 1, shkronjat “b”, “c”, nenin 103 pika 4 e vijues të K.Pr.Penale

⁷ Shih, neni 19/3 i KDPM-së

⁸ Shih, nenet 19, 48, 49 të KDPM-së dhe neni 58/a e vijues i K.Pr.Penale.

2. Prokurori mund të vendosë zbatimin e masës së shmangies deri në momentin para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes.

3. Zbatimi i masës së shmangies vendoset pas analizës së kritereve dhe kushteve ligjore dhe caktimi i masës konkrete alternative të mundshme, mbështetet në raportin e vlerësimit individual.

4. Për të siguruar të drejtën e pjesëmarrjes dhe mbrojtjes së drejtpërdrejtë të të miturit në konflikt me ligjin, i jepen informacioni për njohuri të nevojshme mbi procedurën, kushtet, kriteret dhe detyrimet që lindin me masën e shmangies nga ndjekja penale. Të miturit, i vihet në dispozicion “Informacion për shmangien nga ndjekja penale”, sipas modelit Aneksi 9 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 7

E drejta për t'u dëgjuar dhe marrja në pyetje⁹

1. Prokurori dhe oficeri i Policisë Gjyqësore duhet të garantojnë të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe t'a informojnë atë mbi të drejtën për të heshtur ose mos dëshmuar për ta mbrojtur nga vetinkriminimi.

2. Prokurori duhet t'i bëjë të ditur të miturit se çdo e dhënë do të mbahet në mënyrë konfidenciale dhe do të përdoret vetëm për qëllime të këtij procedimi penal.

3. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, duhet të sigurojnë marrjen në pyetje të të miturit në një ambjent miqësor, duke krijuar kushte të përshtatshme në përputhje me gjininë, gjendjen e tij shëndetësore dhe psikologjike. Marrja në pyetje duhet të zhvillohet pa ndërprerje apo ndërhyrje të personave të paautorizuar, përvçe rasteve kur ndërprerja diktohet nga gjendja shëndetësore, psikologjike apo mungesa e përqëndrimit nga i mituri.

Neni 8

Caktimi i masave të sigurimit¹⁰

1. Prokurori në kërkimin e tij për vendosjen e masave të sigurimit ndaj të pandehurit të mitur, duhet të mbajë parasysh caktimin e asaj mase sigurimi që realizon qëllimin e saj, duke arsyuar bazuar në interesin më të lartë të të miturit dhe nevojën për mosndërprerjen e proceseve të tij edukative, të mirërritjes dhe zhvillimit normal.

2. Masa e sigurimit “arrest në burg” mund të kërkohet vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme, vlerësuar kjo në mënyrë të kujdeshme në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe vetëm nëse ekziston një nga këto kritere:

- a) sanksioni i veprës penale parashikon dënim në minimum 7 vjet;
- b) i miturit përbën rrezik serioz për veten dhe për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me mënyra të tjera;

⁹ Shih, neni 76 i KDPM-së.

¹⁰ Shih, neni 81 e vijues i KDPM-së.

c) përpinqet t'i shmanget drejtësisë.

Neni 9

Vlerësimi i procesit hetimor

1. Për të vlerësuar zbatimin e rregullave dhe respektimin e garancive ligjore në çështjet me të mitur, në mënyrë objektive, të njëjtë dhe të plotë, prokurorët në mënyrë të unifikuar verifikojnë plotësimin gjatë hetimit të detyrimeve dhe kushteve të përshkruara në modelet standard bashkëlidhur:

- a) “Lista e kontrollit për prokurorët që hetojnë çështjet me të mitur në konflikt me ligjin”, Aneksi 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b) “Lista e kontrollit për prokurorët që hetojnë çështjet me viktima të mitur”, Aneksi 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- c) “Lista e akteve të fashikullit të gjykimit për procedimin penal”, (aktet që duhet të mbajë fashikulli i prokurorit që dërgohet në gjykatë), Aneksi 4 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 10

Përdorimi i akteve të unifikuara

2. Në çështjet me të mitur në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikSION të përgjithshëm, në mënyrë të unifikuar prokurorët ose oficerët e policisë gjyqësore përdorin modelet e akteve procedurale pjesë përbërëse të këtij udhëzimi, për disponimet si vijon:

- a) “Urdhër i prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal me burgim”, sipas modelit Aneksi 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- b) “Urdhër i prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal me pezullim të dënimit me burgim”, sipas modelit Aneksi 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- c) “Vendimi i prokurorit për përgatitjen e raportit të vlerësimit individual të të miturit në konflikt me ligjin”, sipas modelit Aneksi 7 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

KREU III

MBI TË MITURIN VIKTIMË DHE/OSE DËSHMITAR

Neni 11

E drejta për t'u informuar dhe për pjesëmarrje¹¹

1. Për të siguruar të drejtën e pjesëmarrjes dhe mbrojtjes së drejtpërdrejtë të të miturit viktimë, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore menjëherë dhe gjatë gjithë procesit, duhet t'i ofrojë në formën më të përshtatshme për moshën, gjuhën dhe kapacitetin e tij për të

¹¹ Shih, nen 33 i KDPM-së

kuptuar, informacion pér asistencën ligjore dhe psikologjike falas, shërbimet mjekësore, masat mbrojtëse në dispozicion, procedurat e drejtësisë penale, vendin e kohën e marrjes në pyetje, ecurinë e çështjes, të drejtën pér të kërkuar dëmshpërblim pér veprën penale të kryer ndaj tij, statusin e të pandehurit, planifikimin e seancave dëgjimore dhe vendimet që jepen, mjetet ligjore pér ankim, shprehjen e mendimit të tij dhe të drejta të tjera të zbatueshme sipas ligjit, si dhe i vihet në dispozicion “Letra e të drejtave të viktimës”, sipas modelit Aneksi 8 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore duhet të informojnë të miturin se nuk ka pér detyrë të dëshmojë pér të dhëna dhe fakte mbi ngjarjen nga të cilat lind vetëpërgjegjësia e tij.

3. Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore duhet të informojnë të miturin dëshmitar në moshën 14-18 vjeç, se ai ka detyrimin pér të dëshmuar përparrë gjykatës dhe pér t'ju përgjigjur me vërtetësi pyetjeve.

4. Të gjitha veprimet e mësipërme përshkruhen dhe në procesverbalin përkatës.

Neni 12

Marrja e të dhënave të miturit të dëmtuar/dëshmitar të veprës penale¹²

1. Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, marrin të dhëna nga i mituri viktimë ose që mund të tregojë rrethana të dobishme pér qëllime të hetimit, duke siguar paraprakisht kushtet e nevojshme që i mituri të shpreh lirisht dhe në mënyrën e tij, pikëpamjet dhe shqetësimet lidhur me procesin penal, sigurinë lidhur me të akuzuarin dhe ndjenjat e tij pér përfundimin e procesit. Këto kushte përfshijnë pa u kufizuar:

- a) Marrjen e deklarimeve/pyetjen me praninë e prindit ose kujdestarit ligjor, një personi mbështetës të zgjedhur nga i mituri, si dhe të një specialisti;
- b) Marrjen e deklarimeve/pyetjen e të miturit në një mjedis të përshtatshëm pér të, si shkolla, shtëpia apo një qendër pér mbështetjen e të miturve;
- c) Marrjen e masave në mënyrë që të kufizohet sa më shumë numri i marrjes në pyetje duke regjistruar deklarimet me shkrim, audio ose video;
- ç) Të kërkohet nga gjykata marrja e dëshmisë së të miturit me mjete audiovizuale;

2. Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore marrin konfirmimin nga eksperti psikolog, që i mituri viktimë/dëshmitar i një vepre penale ka aftësinë fizike, mendore apo emocionale pér të deklaruar në një kohë të caktuar apo në përgjithësi.

3. Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore gjatë marrjes së deklarimeve nga i mituri duhet të sigurojnë asistencën e një personi mbështetës, por nuk duhet të lejojnë që këta persona t'i përgjigjen pyetjeve që i bëhen të miturit. Në këtë proces duhet të merret parasysh çdo kërkesë e të miturit në rastet kur ai kërkon që të mos jenë të pranishëm persona të tjerë.

4. Të miturit viktimë/dëshmitar të veprës penale i shpjegohet qëllimi dhe roli i tij në këtë proces sipas parashikimit në Ankesin 8, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

¹² Shih, nen 39 i KDPM-së

Neni 13

E drejta për asistencë të efektshme

1. Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, me praninë e koordinatorit duhet t'i bëjnë të ditur të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar, se gjëzon të drejtën të përfitojnë shërbime mbështetëse financiare, ligjore, këshillimore, shëndetësore, sociale, arsimore apo shërbimeve të tjera të nevojshme për riintegrimin e tij.

2. Prokurori duhet të monitorojë mundësinë që kanë të miturit për të përdorur shërbimet mbështetëse të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Prokurori duhet të kërkojë caktimin e një kujdestari për fëmijën ose zbatimin e masave të tjera të asistencës, kur është rasti sipas ligjit.

Neni 14

Mbrojtja nga vështirësitet e procesit penal

1. I mituri viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale duhet të sigurohet se do të jetë i mbrojtur nga organet shtetërore në lidhje me pasojat që mund të ketë nga roli i tij në këtë procedim.

2. Prokurori duhet të marrë masa që seancat e deklarimeve të mos jenë të tejzgjatura dhe për të shmangur përsëritjen e panevojshme të tyre.

3. Prokurori duhet të njohë dhe familjarizojë të miturin me procedurën në seancat gjyqësore, përpara daljes në gjyq.

Neni 15

Sigurimi i provës

1. Gjatë hetimeve në procedimet penale ku të miturit përfshihen si viktima dhe/ose dëshmitar, prokurori vlerëson rast pas rasti nevoja për të kërkuar në gjykatë “sigurimin e provës” sipas ligjit, në mënyrë që të shmanget përsëritja e veprimeve hetimore, si marja e deklarimeve/dëshmisi së të miturit, veprimet e njohjes, ekspertimet ose veprime të tjera hetimore, si dhe për të siguruart provueshmërinë e akuzës.

2. Kur është e mundur, prokurori duhet të kërkojë nga gjykata që në seancën e sigurimit të provës i mituri të pyetet në distancë me anë të lidhjes audiovizive sipas ligjit.

Neni 16

E drejta për siguri

1. Në rastet kur i mituri viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale është objekt kanosje, kërcënimi ose dëmtimi, prokurori menjëherë pasi vihet në dijeni merr masat e mëposhtme:

- fillon procedimin penal ndaj personit përgjegjës, kur është rasti;
- kërkon nga gjykata sipas rastit caktimin/ndryshimin e masës së sigurimit personal të përshtatshme (“arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”), për personin përgjegjës;

- c) kur është e nevojshme i sigurohet të miturit mbrojtje nga policia e shtetit sipas ligjit, përsa kohë vlerësohet e nevojshme;
- d) merr masa për të shmangur kontaktin mes të miturit dhe autorëve të veprës penale gjatë hetimeve paraprake, dhe kërkon nga gjykata të veprojë në të njëjtën mënyrë edhe gjatë procesit gjyqësor.

Neni 17
Pyetja e viktimës së mitur femër

1. Në çështjet me të mitura viktima të dhunës, çdo vendim dhe veprim merret duke respektuar parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Kodit të Procedurës Penale, duke vlerësuar me përparësi interesin më të lartë të të miturit.

2. Në pyetjen e viktimës së mitur të mbahet në konsideratë:

- a) përpala intervistimit/pyetjes së të miturit të sigurohet informacioni i nevojshëm mbi viktimen, ngjarjen dhe të dhëna të tjera që të ndihmojnë në zhvillimin e një interviste sa më të plotë;
- b) të kufizohet numri i intervistimeve/pyetjeve dhe kontakteve me procesin penal;
- c) të trajtohet me dinjitet dhe dhembshuri;
- d) të mos diskriminohet ose të pengohet të marrë pjesë në proces për shkak të moshës;
- e) të intervistohet në ambiente miqësore për të mitur dhe gjatë orareve të përshtatshme për moshën e tyre;
- f) me ndihmën e psikologut të ndërtohet një taktikë paraprake për intervistimin/pyetjen, ku të përfshihet prezantimi me të miturën, krijimi i kontaktit me të, sigurimi i besimit se të folurit për këtë çështje është gjëja e duhur, kërkimi i informacionit për ato çështje të cilat shërbejnë për të vlerësuar nivelin e riskut ku ndodhet viktima etj.;
- g) gjatë intervistimit/pyetjes:
 - fjalitë të jenë të shkurtra dhe të thjeshta;
 - fjalitë të jenë në formën pohore;
 - fjalitë të kenë vetëm një kuptim;

KREU V
POLITIKA PENALE

Neni 18
Akuzat dhe kërkesa për dënimin e të pandehurit të rritur

1. Prokurori, në formulimin e akuzës, krahas kërkesave të tjera ligjore, vlerëson dhe konsideron rëndësinë e veprës, paramendimin dhe/ose vazhdimësinë e sjelljes së të pandehurit, formën e fajit (dashje apo pakujdesi), pasojën/dëmin (fizik e psikologjik) të shkaktuar viktimës, vepra të tjera shoqëruese.

2. Në kërkimin për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, prokurori merr në konsideratë rëndësinë dhe/ose rrezikshmërinë e veprës, vazhdueshmërinë dhe/ose përsëritjen e saj, personalitetin dhe rrezikshmërinë e autorit, recidivizmin, pasojat e shkaktuara viktimsës dhe/ose rrezikun për pasoja të mëtejshme ndaj saj, rrethanat rënduese, përhapjen e veprës penale në njësinë/rrethin gjyqësor apo në shkallë vendi dhe nevojën e shoqërisë për mbrojtjen dhe ndëshkimin e autorëve të këtyre veprave dhe nevojat për rehabilitimin e autorit.

3. Kur i pandehuri është person që ushtron përgjegjësinë prindërore, në kërkesën për dënimin e tij si autor ose bashkëpunëtor në një vepër penale ndaj fëmijës ose si bashkëpunëtor me fëmijën në kryerjen e një vepre penale, bashkë me dënimin kryesor mund të kërkohet edhe dënimini plotësues i heqjes së përgjegjësisë prindërore.

Neni 19

Roli i prokurorit gjatë shqyrtimit gjyqësor

1. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokurori duhet të udhëhiqet nga mbrojtja dhe mbështetja e interesit më të lartë të fëmijës. Mbi këtë parim duhet të organizohet përfaqësimi i akuzës në gjyq.

2. Prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk duhet të komentojë apo veprojë në mënyrë të tillë që të paragjykohet se vendimarrja e gjykatës është në favor të tij.

Neni 20

Kërkesa për dënimin e të pandehurit të mitur

1. Prokurori në kërkesën për caktimin e dënimit, analizon dhe vlerëson rëndësinë e shkeljes, shkallën e fajësisë, pasojën shkaktuar viktimsës, shkallën e pjekurisë së të miturit, kohën që nevojitet për edukimin dhe formimin profesional të tij, etj. Në çdo rast prokurori vlerëson dhe konsideron parësore interesin më të lartë të fëmijës që është rehabilitimi dhe riintegrimi i tij në shoqëri.

2. Prokurori, në parim, duhet të mbështesë caktimin e dënimive alternative (jo me burgim) duke i konsideruar ato si masat më të përshtatshme në interes të të miturit, që nxisin dhe krijojnë mundësinë e ruajtjes së kontakteve të të miturit me familjen, shkollën e shoqërinë.

3. Aplikimi i dënimit me burgim të të miturit, vlerësohet dhe zbatohet si masë e fundit për vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore për të cilat ligji parashikon sanksionin në minimum 7 vjet burgim dhe për një periudhë sa më të shkurtër.

Neni 21

Masa gjatë mbikëqyrjes së vuajtjes së dënimit

1. Gjatë mbikëqyrjes së vuajtjes së dënimit, prokurori vlerëson dhe konsideron me kujdes të veçantë çdo informacion apo ankesë në lidhje me mënyrën e ekzekutimit të

dënimit me burgim për të dënuarin e mitur duke marrë masa për t'i garantuar të gjitha të drejtat sipas ligjit, trajtimin me dinjitet, ndalimin e dhunës, zbatimin e masave disiplinore.

2. Prokurori i caktuar me ekzekutimin e vendimeve penale, vlerëson dhe cakton institucionin e posaçëm të vuajtjes së dënimit për të miturin, ku do ti garantohet programi arsimor, edukativ, kulturor i përshtatshëm për të miturin e dënuar me burgim.

3. Prokurori merr masat e duhuara, që i mituri të vendoset në institucionet e vuajtjes së dënimit, që janë afër vendit ku ai banon, për të garantuar të drejtën e të miturit të dënuar me burgim dhe për të mbajtur lidhjet e kontaktet me familjen e rrëthim shoqëror të tij.

KREU VI **MASA TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE**

Neni 22 **Kontrolli i veprimtarisë së policisë gjyqësore**

1. Prokurori duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë, kontrollit të ligjshmërisë dhe vlefshmërisë të akteve hetimore të administruara nga policia gjyqësore dhe profesionalizmit në kryerjen e hetimeve nga oficerët e policisë gjyqësore.

2. Prokurori duhet të vlerësojë çdo ankesë të paraqitur në çështjet me të mitur, për veprime në shkelje të ligjit nga personeli i shërbimeve të policisë gjyqësore në strukturat hetimore përkatëse, dhe jo vetëm.

3. Prokurori duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë të drejtës së të miturit për të mos i'u nënshtuar asnjë forme dhune, fizike apo psikologjike, dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme në rast të konstatimit të shkeljes së kësaj të drejte, për rivendosjen e saj përsa është e mundur, dhe për procedimin e fajtorëve.

4. Prokurori gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve penale duhet t'i kushtojë rëndësi marrjes së informacionit nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve, jo vetëm lidhur me respektimin e detyrimeve, por edhe pjesëmarjen e të miturit në programe edukuese dhe rehabilituese, si dhe ndikimin e këtyre programeve në edukimin e tij.

5. Prokurori duhet të verifikojë pa vonesë çdo shkelje të ndalimeve ligjore nga punonjësit e policisë gjyqësore lidhur me ndalimin e publikimit të fotografive, gjeneraliteteve, të dhënavë të tjera personale dhe çdo informacioni tjetër që mund të çojë në identifikimin e të miturit, dhe sipas rastit të vlerësojë fillimin kryesisht të ndjekjes penale ndaj personave përgjegjës, dhe/ose të njoftojë organin që ka të drejtë të marrë masë ndaj tyre sipas ligjit.

Neni 23 **Bashkëpunimi**

1. Drejtuesit e prokurorive duhet të nxitin bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional me strukturat hetimore përkatëse pranë shërbimeve të policisë gjyqësore apo agjencive të tjera ligjzbatuese dhe me organizata të shoqërisë civile, hartimin e

protokolleve e strategjive, në kryerjen e trajnimeve dhe trajtimin e rasteve ku përfshihen të miturit.

2. Prokurorët në trajtimin e çështjes duhet të marrin masa gjithëpërfshirëse, jo vetëm në drejtim të garantimit të të drejtave ligjore të të miturit, por duhet të sigurojnë që këto masa të koordinohen me ato të agjencive të tjera si në shërbimet e policisë gjyqësore në policinë e shtetit dhe shërbimet sociale, në mënyrë që të jenë efektive dhe të kenë në qendër mbrojtjen e veçantë të të miturit.

Neni 24
Trajnimi

1. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në strukturat hetimore të veçanta për të miturit, si dhe koordinatorët e viktimave, kanë të drejtë dhe detyrim të trajnohen mbi kuadrin legjislativ ndërkombëtar dhe kombëtar në këtë fushë, për të rritur kapacitetin profesional të tyre.

2. Trajnimet për prokurorët dhe policinë gjyqësore duhet të fokusohen edhe në protokollet/metodikat dhe teknikat e hetimit, masat alternative të shmangjes, drejtësinë restauruese, përdorimin e mjeteve të posaçme hetimore, për mbledhjen dhe administrimin e provave, mbrojtjen e viktimave, etj.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25
Njohja

Me këtë udhëzim të njihen gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve pranë strukturave hetimore përkatëse në Policinë e Shtetit, dhe koordinatorët e viktimave në prokuroritë e juridikzionit të përgjithshëm.

Neni 26
Shkeljet dhe verifikimet disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit¹³ dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve ndaj oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm nga Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, sipas ligjit.

13 Shih, nenin 101 pika 1 shkronja "a", "b" dhe nenin 102 pika 1 shkronjat "ç", "d", "dh", "ë", "g" "j", "l" "ll", "nj" dhe pika 2 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d" "dh" e vijues të ligjit nr.96/2016 i ndryshuar me ligjin nr. 48/2019.

Neni 27

Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurorive me juridikSION të përgjithshëm, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve pranë strukturave hetimore përkatëse në Policinë e Shtetit, si dhe koordinatorët e viktimateve në prokuroritë e juridikSIONIT të përgjithshëm.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimin e këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohen drejtuesit e prokurorive të juridikSIONIT të përgjithshëm dhe Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm.¹⁴

Neni 28

Sistemi i integruar dhe mbledhja e të dhënave

1. Prokuroritë e shkallës së parë të juridikSIONIT të përgjithshëm do të mbledhin e raportojnë të dhëna statistikore për çështjet me të mitur në përputhje me urdhrin nr.124, datë 24.09.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Hedhja e të dhënave në Sistemin e Integruar të të Dhënave për të Mitur, kryhet në përputhje me urdhrin nr.87, datë 28. 2021 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 29

Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM



¹⁴ Po aty nen 46 pikë 4.